



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 38, datë.02.04.2024

PËR
MIRATIMIN E LEJES SË ZHVILLIMIT PËR OBJEKTIN:
GODINË SHËRBIMI HOTELERIE ME 8 KATE MBI TOKË DHE 2 KATE NËNTOKË
ME VENDNDODHJE NË RRUGËN "HORIZONT", BASHKIA DURRËS

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28, pika 1, të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar; neneve 9 dhe 10/1, të Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullore së zhvillimit të territorit", i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit", me propozim të shoqërisë "Bonita Konstruksion" sh.p.k., Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: "Godinë shërbimi hotelerie me 8 kate mbi tokë dhe 2 kate nëntokë", me vendndodhje në Rrugën "Horizont", Bashkia Durrës, me subjekt zhvillues shoqërinë "Bonita Konstruksion" sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullore së Veçantë bashkëlidhen si pjesë përbërëse e këtij Vendimi.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT
MIRELA KUNIBARO FURXHI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TE TERRITORIT
ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 04/09/2024